



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË**

**NOTER MAJLINDA I. LLESHI
ADRESA SULEJMAN DELVINA
TEL: 692036636**

VERTETIM NENSHKRIMI

(AKT THEMELIMI)

Nr. repertori: 5427


Tirane më 09/12/2021

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"



V2021053300346565563



AKT THEMELIMI
I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"SAFECOMM" shpk

Ne Tirane, sot me date 03.12.2021, (dymije e njezet e nje), ne personat e meposhtem :

MENELAOS THEOCHAROPOULOS, lindur në ATHINE dhe banues në ATHINE, me adresë Athine Greqi, lindur më 27/11/1971, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaporten Greke AT1082867, nenshkruan aktin ne prani te perkthyeses me License Znj. Isida Foçi.

Filip DEÇKA, atësia Dhimitër, amësia Vangjeli, shtetas Shqiptar, lindur në Topove, Gjirokastrë dhe banues në Gjirokastrë, me adresë 18 Shtatori; Nd. 000; H. 0; Ap. 0; Gjirokastrë; Gjirokastrë; 6001; Gjirokastrë, lindur më 23/10/1960, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037919485 dhe nr. personal G01023095T,

*me cilesine e "Ortakeve Themelues", redaktojne kete akt themelimi, nepemjet te cilit deklarojme se me vullnet të lire të plote e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare", me ndryshimet perkatese, ne ligjin "Per QKR", ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin **"SAFECOMM"** shpk.*

KREU I

Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1

Emertimi

Emertimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është **"SAFECOMM"** shpk.

Neni 2

Forma Juridike

Shoqëria **"SAFECOMM"** shpk, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqëria"), e themeluar nga personat fizikë të siperpermendur, të cilët nuk përgjigjen për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Secili ortak gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital. Kapitali i regjistruar i shoqërisë ndahet ndërmjet ortakëve në kuota, sipas këtij raporti.

Neni 3

Selia

Shoqëria e ka seline ne, Tirane, Rr Jusuf Vrioni, P.5, Ap 8, Shk.1, Njesia Administrative Nr 5.

Shoqëria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Asamblese se Ortakeve.



Neni 4
Objekti

Shoqëria do të ushtroje aktivitet tregtar me objekt.

- 1) Prodhimi artizanal ose industrial, montimi, tregtimi dhe shitja e produkteve dhe shërbimeve të teknologjisë së lartë në fushat e veta, përpunimi dhe transferimi i telekomunikacionit të të dhënave, imazhit, zërit dhe tekstit si dhe sistemet për automatizimin e objekteve të prodhimit, planifikimin dhe kontrollin e tyre, për llogari personale ose tjetër.
- 2) Blerjen, prodhimin industrial ose artizanal dhe shitjen e mikroqarqeve dhe sistemeve elektronike/dixhitale.
- 3) Blerja, projektimi, prodhimi, marketingu dhe mbështetja e programeve softuerike.
- 4) Projektimi, zhvillimi, instalimi, funksionimi dhe funksionimi i teknologjisë së rrjetit të telekomunikacionit dhe ofrimi i shërbimeve me vlerë të shuar.
- 5) Ofrimi i konsulences, shërbimeve dhe zhvillimi i studimeve për çështjet e telekomunikacionit për personat fizikë ose juridikë, vendas dhe të huaj.
- 6) Ofrimi i shërbimeve, konsulenteve, përpunimi i studimeve dhe organizimi i skenarëve të trajnimit në lidhje me organizimin, rritja e produktivitetit dhe cilësisë së shërbimeve të sipërmarrjeve.
- 7) Ofrimin e shërbimeve, konsulenteve dhe përpunimin e studimeve në lidhje me kërkimin, promovimin dhe shfrytëzimin e të gjitha llojeve të produkteve dhe mallrave, materialeve dhe jomaterialeve.
- 8) Ofrimi i shërbimeve, konsulenteve dhe përpunimit të studimeve në lidhje me promovimin, kërkimin dhe zhvillimin e të gjitha llojeve të kompanive tregtare dhe teknike.
- 9) Ofrimi i shërbimeve, konsulenteve dhe përgatitja e studimeve në lidhje me kërkimin, vlerësimin dhe zhvillimin e tregut.
- 10) Importi, marketingu, shitja dhe mbështetja teknike e produkteve dhe mallrave që lidhen me objektin e Shoqërisë.
- 11) Studimi, mbikëqyrja e projekteve dhe punët teknike lidhur me objektin e Shoqërisë.
- 12) Transferimi dhe zhvillimi i teknologjisë për prodhimin e produkteve dhe mallrave që lidhen me objektin e mësipërm të Shoqërisë.
- 13) Projektimi, zhvillimi, prodhimi dhe shitja e sistemeve të teknologjisë së re (HARDWARE, SOFTWARE), pjesëmarrja në programe të subvencionuara, ofrimi i mirëmbajtjes, trajnimit dhe shërbimeve mbështetëse për funksionimin e tyre.
- 14) Dhënia me qira e pajisjeve dhe shërbimeve që lidhen me objektin e Shoqërisë.
- 15) Lidhja e kontratave leasing me kompani vendase ose të huaja.
- 16) Bashkëpunimi dhe pjesëmarrja në programe kërkimore së bashku me organizma të huaj për zhvillimin e produkteve apo shërbimeve si më sipër.
- 17) Sipërmarrja në çdo formë e përfaqësimit të personave fizikë ose juridikë vendas ose të huaj, të angazhuar në industri ose tregti të ndonjë prej produkteve, mallrave dhe shërbimeve të lartpërmendura.
- 18) Çdo punë, transaksion ose veprim që lidhet me qëllimet e mësipërme të shoqërisë, i cili është i nevojshëm ose në çfarëdo mënyre i dobishëm për realizimin e qëllimeve të mësipërme.
- 19) Pjesëmarrja në ndërmarrje industriale dhe tregtare ekzistuese ose të krijuara që ndjekin qëllime të ngjashme ose të lidhura me to ose krijimi i ndërmarrjeve të tilla me vendim të mbledhjes së përgjithshme të ortakëve, si dhe koperimi me persona të tretë, fizikë ose juridikë dhe krijimi i një konsorciumi me ta.
- 20) Ndërmjetësim, me komision për përfundimin e çdo lloj transaksioni apo transaksioni tregtar në Shqipëri dhe jashtë saj.
- 21) Pjesëmarrja e shoqërisë në tendera dhe ankande në të gjithë sektoret publik ose privat.
- 22) Ofrimi i shërbimeve për:
 - Telekomunikacioni me tel
 - Aktivitetet e telekomunikacionit pa tela



- Aktivitetet e telekomunikacionit satelitor
 - Menaxhimi i sistemeve elektronike.
 - Kompjuterë
 - Aplikacionet operative
 - Portale në internet dhe portal
 - Sistemet elektronike të zbulimit, kontrollit dhe sigurisë
- 23) Shërbime konsulence dhe kërkimore për sigurinë dhe mbrojtjen e të dhënave dhe informacionit, në formë të shtypur dhe elektronike, dhe në hapësirën kibernetike

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në QKB.

KREU II **KAPITALI**

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është **3.500.000 leke** dhe është i përbërë nga **2 kuota**.

- Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është tërësisht i nënshkruar, i papaguar, ndahet në dy kuota me vlerë, që përbejnë 100% të kapitalit të shoqërisë, që zotërohet nga Ortaket, i ndarë në dy kuota, si më poshtë :

Filip Deçka, zoteruesi i 1 kuote, që përben 50 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 1.750.000 leke.

Menelaos Theocharopoulos, zoteruese e 1 kuote, që përben 50 % të kapitalit të përgjithshëm të shoqërisë, me vlerë të përgjithshme 1.750.000 leke.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.



Ky statut kushtëzon kalimin e kuotave të treteve jashtë shoqërisë, me miratimin e shoqërisë dhe të drejtën e parablerjes në favor të shoqërisë apo të ortakëve të tjerë, sipas modaliteteve dhe shumicës së cilesuar që kërkon ndryshimi i statutit.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimarrës

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, vendos me votat e te pakten tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, që janë pjesëmarrës në mbledhje.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administratore.

Administratore e shoqërisë do të jete **z. Filip Deçka**, i cili do të ushtroje funksionet në këto detyra për një periudhë **5 vjetore me të drejtë ripërteritje**.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë. Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit do të jete të pakufizuara dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;

c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi asamblenë e përgjithshme edhe në rastet kur :

- Asambleja e përgjithshme thirret pasi, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe

- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike,



publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombetare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

Në këto rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këtë statut dhe dispozitat e legjislativës shqiptare.

Per sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 16

Dispozita perfundimtare



Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga ortakët e shoqerise tregtare, nenshkruajne ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale, autenticiteti i të ciles vertetohet nga Noteri.

Ngarkohet Z. Nikolla Gjoni per depozitim te ketyre akteve prane QKB.

ORTAKET THEMELUES

Filip DEÇKA

Filip Deçka
[Signature]

Menelaos Theocharopoulos

Menelaos Theocharopoulos
[Signature]

ISIDA FOÇI
PERKTHYES ZYRTAR
Επισημως μεταφραστης
[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË
NOTER MAJLINDA I. LLESHI



DATE 09/12/2021
NR REP 5427

VËRTETIM NËNSHKRIMI

Sot, më datë 09.12.2021, para meje Notere MAJLINDA I. LLESHI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tirane, SULEJMAN DELVINA, u paraqiten personalisht:

NENSHKRUESIT:

MENELAOS THEOCHAROPOULOS, lindur në ATHINE dhe banues në ATHINE, me adresë Athine Greqi, lindur më 27/11/1971, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Pasaportën Greke AT1082867, nenshkruan aktin në prani të perkthyeses me License Znj. Isida Foçi.

Filip DEÇKA, atësia Dhimitër, amësia Vangjeli, shtetas Shqiptar, lindur në Topove, Gjirokastër dhe banues në Gjirokastër, me adresë 18 Shtatori; Nd. 000; H. 0; Ap. 0; Gjirokastër; Gjirokastër; 6001; Gjirokastër, lindur më 23/10/1960, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 037919485 dhe nr. personal G01023095T,

Me vullnetin e tyre të lire, të plote dhe të singërte, me cilesine e ortakeve themelues te shoqërisë **“SAFECOMM” sh.p.k.**, kane redaktuar jashte kesaj zyre ne gjuhen shqipe, **Aktin e Themelimit** te mesiperm dhe deklarojne se e kane lexuar dhe e kane kuptuar gjithcka ne lidhje me keto akte dhe e nenshkruar pa verejtje duke shkruar emrin mbiemrin dhe firmen e tyre orgjinale ne kete zyre para meje Noteres.

Unë Noterja, pasi verifikova identitetin e personave të sipërcituar, nëpërmjet mjeteve të identifikimit në përputhje të plotë me nenin 62, pika 1, gërma "ë", si dhe nenit 128 të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", dhe Udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë nr. 6291, datë 17.08.2005; vërtetoj nënshkrimin e tyre.

Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave Personale", unë noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpujoj të dhënat personale të subjektit të këtij veprimi në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

NOTER

MAJLINDA I. LLESHI

